

**SHOQËRIA "PËRPARIMI" SH.A.  
SHKOZET – DURRËS**

---

**V E N D I M**

**I ASAMBLESË SË JASHTËZAKONSHME TË AKSIONERËVE**

**SHOQËRISË "PËRPARIMI" SH.A.**

Sot më datën 25.07.2005, në selinë e shoqërisë "Përparimi"sh.a., në Shkozet, Durrës, u mbledh Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve të Shoqërisë, në të cilën ishin të pranishëm:

-Shoqëria "**Felmont Trading Limited**", e cila zotëron 51% të aksioneve të shoqërisë dhe si rezultat 51% të votave, e përfaqësuar me autorizim të posaçëm nga Znj.**Aikaterini Donta**.

- **Z. Kristo Delijorgji**, i cili zotëron 49% të aksioneve dhe si rezultat 49% të votave, i pranishëm drejtpërsëdrejti.

- **Z.Mihal Delijorgji**, si Drejtor i Përgjithshëm i Shoqërisë dhe si drejtues i mbledhjes, pa të drejtë vote.

- Znj. **Leze Abazi**, eksperte kontabël, pa të drejtë vote.

- Znj. **Dorina Asllanaj**, juristja e shoqërisë dhe mbajtësja e procesverbalit, pa të drejtë vote.

Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve të Shoqërisë "Përparimi"sh.a. e mbledhur sot më datën 25.07.2005, në selinë e shoqërisë, në Shkozet Durrës, pasi mori në shqyrtim rendin e ditës të caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm, **Z. Mihal Delijorgji**, si më poshtë:

1. Të miratohet raporti i ekspertës kontabël për zmadhimin e kapitalit nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri në 31.12.2004.

**K O N S T A T O I   S E :**

**Z.Mihal Delijorgji** me cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë "Përparimi"sh.a. i ka paraqitur asamblesë së aksionerëve kërkesën për miratimin e raportit të ekspertit kontabël për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë, nga fitimet e realizuara deri më 31.12.2004. Eksperti kontabël, Znj. **Leze Abazi** është miratuar me vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të datës 24.06.2005 dhe të regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin Nr.6657/7, të datës 28.06.2005. Ky zmadhim do të bëhet në bazë të dokumentacionit që disponon shoqëria pa ndryshuar përqindjet e pjesëmarrjes së aksionerëve në kapitalin e shoqërisë.

Në diskutimet e bëra, aksionerët e shoqërisë u shprehën për miratimin raportit të ekspertit kontabël, për zmadhimin e kapitalit nga fitimet e realizuara deri në 31.12.2004,



në përputhje me dokumentacionin bazë si: bilanceve kontabël, pasqyrave financiare dhe raportit të auditimit të ekspertit kontabël.

Për sa më lart në mbështetje të Statutit të Shoqërisë Lgjit Nr.7638, dt 19.11.1992, "Për shoqëritë tregtare", Asambleja e Jashtëzakonshme e Shoqërisë

## VENDOSI

1. Miratimin e raportit të ekspertit kontabël, për zmadhimin e kapitalit themeltar nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri në 31.12.2004, dhe konkretisht me 24.958.932 lekë-21.432 lekë (që nuk plotësojnë masën e një aksioni). Konkretisht kapitali themeltar që ishte në shumën 165.862.500 lekë do të shtohet me 24.937.500 lekë, pra kapitali bëhet 190.800.000 lekë.

Ky kapital zotërohet nga ortakët sipas përqindjeve të pjesëmarrjes nga:

~ Shoqëria "Felmont Trading Limited" me pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërisë prej 51%, ose 97.308.000 lekë.

~ Kristo Delijorgji me pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë prej 49%, ose 93.492.000 lekë.

2. I gjithë dokumentacioni i përgatitur për zmadhimin e kapitalit themeltar nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri më 31.12.2004, të shoqërisë "Përparimi"sh.a., të depozitohet në Regjistrin Tregtar sipas kërkesave të Ligjit "Mbi Shoqëritë Tregtare" dhe Statutit të shoqërisë.

Ky vendim u miratua unanimisht nga aksionerët.

*AKATERINI DONTA* AKSIONERËT

Për: "Felmont Trading Limited"

**FELMONT TRADING LTD.**

NICOSIA - CYPRUS



*Kristo Delijorgji*  
Kristo DELIJORGJI

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE DURRES

Nr. 2270 Rep.

VERTETIMI



Në Durrës, sot më datën 03.09.2005, (Tre Shtator Dymijë e pesë), unë noter **Bastri Meçaj**, me zyrë noteriale në Rr. "A.Goga", Banesa 385 në Durrës, pasi u sigurova për cilësitë dhe identitetet, e përfaqësuesve të Shoq."Përparimi" SH.A., me seli në lagjen 14, Shkozë, Durrës, aksioneri Z.-Kristo Delijorgji; me banim në lagjen Nr.1, Durrës, me Pasaportë Nr.1020249, dhe përfaqësuesia e Shoq. "Felmont-Trading-Limited; me qendër në Qiprio, Z.-Aikaterini Donta, me banim në Rr. "Trapezudos" nr.24; Athinë, Greqi, me Pasaportë 799192, lëshuar në Athinë; me cilësitë dhe identitetet si më lartë; **të dy janë** madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, të cilët deklarojnë se janë dakort me Vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve në fjalë; të Shoqërisë së përbashkët me të huaj, "Përparimi" SH.a, date 25.07.2005, të cilët më deklarojnë se e kanë hartuar, jashtë kësaj zyre, duke e nënshkruar; **atë** me dëshirë dhe vullnetin e tyre të lirë.-----:

Unë noteri, vërtetoj, nënshkrimet e tyre, sipas ligjit 7829 datë 01.06.94, "Për Noterinë".-----:

**NOTERI**  
**Bastri Meçaj**